

INSPEKTORATI SHITËTËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL						
Regjistri i Kërkesave/Ankesave dhe Përgjigjeve ISHTI SHITATOR 2025						
Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e Përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	27.08.2025	Kërkesë pse nuk verifikohen sasite minimale per te marre dhe mbajtur licensat e tregtimit me shumice dhe mos përmbushja e kriterëve në disa subjekte.	30.09.2025	Në përgjigje të email-it Tuaj, dërguar me datë 27.08.2025, Protokolluar në ISHTI me Nr. 8070 Prot datë 27.08.2025, në të cilin kërkohet, përse nuk verifikoni sasitë minimale që kërkon ligji për të marrë dhe mbajtur licencat e tregtimit me shumicë, ku ka subjekte që nuk kanë këto sasi sa kërkohet prej 3000 meter kub. Subjekti A & T sha nuk e përmbush këtë kriter si dhe për subjekte të tjera që marrin depozita me qira duke krijuar mbivendosje, ju informojmë si më poshtë:Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organ i specializuar për kontrollin e veprimtarisë të personave juridikë në fushën hidrokarbure, ushtron kontrollë në të gjitha subjektet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar; Ligjit nr 32/2016, datë 24.03.2016 “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, si dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tyre. Në zbatim të ligjit Nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” I ndryshuar, si dhe Programeve vjetore dhe mujore të miratuara shoqëritë e pajisura me Licenca të tregtimit me shumicë që kryejnë veprimtari në fushën hidrokarbure janë inspektuar për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë. Nga inspektimi i kryer rezultoi se nuk ka shkelje të kërkesave ligjore si dhe respekton kushtin e kapacitetit të depozitimit sipas përcaktimeve të Kreut III të VKM nr.970, datë 02.12.2015 Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj (ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.4.2017) Në vijim të kërkesës Tuaj, Në zbatim të ligjit Nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, me datë 01.09.2025 Inspektorët e ISHTI, të pajisur me Autorizim Inspektimi Jashtë Programi me Nr. 8240 Prot datë 01.09.2025 kanë inspektuar shoqërinë e tregtimit me shumicë të hidrokarbureve. Nga inspektimi i kryer rezultoi se nuk ka shkelje të kërkesave ligjore si dhe respekton kushtin e kapacitetit të depozitimit sipas përcaktimeve të Kreut III të VKM nr.970, datë 02.12.2015 Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj (ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.4.2017)	E plotë	0
2	01.09.2025	Kerkese per venie ne dispozicion te aktit te ekspertimit Teknik, për shkak te afateve te caktuara nga gjykata.	01.09.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj, mbi venien në dispozicion të aktit të ekspertimit Teknik mbajtur nga ISHTI lidhur me aksidentin , akti është vënë në dispozicion nga institucioni ynë në rrugë zyrtare dhe elektronike informacioni I kërkuar.	E plotë	0
3	02.09.2025	Kërkesë për informacion	09.09.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj vendosjen e bombolave të GLN pranë një restoranti, bazuar në Ligjin Nr.32 datë 24.03.2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, V.K.M. Nr.212 datë 16.3.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm (GLN)”si dhe VKM Nr.1062 datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara” ju bëjmë me dije se: Në asnjë nga dispozitat ligjore të sipërpërmendura nuk citohen kufizime distance apo ndalesa për vendosjen e bombolave të GLN (5 deri në 25 kg) në ambientet e jashtme, përveç rasteve dhe volumeve specifike (taraca, bodrume, hapësira të pa ajrosura mirë, garazhe, pranë pusetave, etj) është bërë verifikimi në vend i këtij subjekti, ku rezultoi se ishte i mbyllur dhe jashtë funksioni në atë moment.Bizneset afër tij deklaruan se ka disa kohë i mbyllur e si pasojë nuk është kontrolluar instalimi, bombolat si dhe dokumentacioni tekniko ligjor i këtij subjekti. Nga sa u pa nga jashtë në vendndodhje si dhe bazuar në fotot e dërguara me e-mail, rezultoi se dollapi metalik i vendosur për mbajtjen e bombolave të GLN në këtë subjekt, plotëson kushtet tekniko-ligjore të ruajtjes dhe shfrytëzimit të bombolave të GLN, referuar legjislacionit të mësipërm (Konstruksin metalik i mbyllur dhe me hapësirë të mjaftueshme ajrimi Përsa më sipër ju bëjmë me dije se ISHTI nuk është Institucioni përgjegjës për kontrollin mbi zaptimin apo bllokimin të hapësirave publike apo të përbashkëta në rastin e instalimit të bombolave të GLN (5 deri 25kg), por ISHTI është Institucioni që ndjek dhe kontrollon sigurinë e instalimit dhe shfrytëzimit si dhe dokumentacionit tekniko-ligjor të instalime të GLN.	E plotë	0
4	16.09.2025	Ankesë ndajur me vendosjen e bombolave të gazit nga aktivitetet private si dhe zënie të hapësirës publike, perballë pallatit, të cilat koha me pare kane qene garazhe te Fakultetit. Gjate verifikimit, ne hapesiren perballë pallatit konstatohet subjekt Bar Kafe i mbyllur prej kohesh. U konstatuan bombola gazi te instaluar duke zene hapesiren publike ne hyrje te pallatit si dhe depozita uji ne hapesire publike.Kerkohet njoftimi i ISHT-it per vleresim te metejshem te situates lidhur me perdorimin e pajisjeve nen presion si dhe rrezikun qe mund te vijone prej tyre.	19.09.2025	Në përgjigje të ankesës tuaj, dërguar me email pranë Ishtit, ju bëjmë me dije se u ushtruar kontroll nga inspektorët e ISHTI-it në subjekt cili nuk ka filluar ende aktivitetin e tij. Nga inspektimi kryer rezultoi se subjekti i mësipërm ka pasur të instaluar pajisje nën presion të transportueshme, konkretisht bombola GLN-je (Gazi) të instaluar jashtë ndërtesës, brenda një dollapi metalik me një kolektor për dy bombola GLN-je . Sa më sipër subjekti i ka hequr bombolat e GLN-s si dhe ka çmontuar dollapin metalik me kolektorin e bombolave të GLN-s. Subjekti u dhanë rekomandime që, në rast se do të përdori pajisje nën presion, para vendosjes në punë të tyre duhet të plotësojë të gjithë dokumentacionin përkatës tekniko-ligjor.		
5	17.09.2025	Ankesë portali lidhur me zënie të hapësirave publike dhe parking pa leje. U verifikua situata ne zone ku u konstatua zënie e hapësirës publike me frigorifer, kase te bombulave te gazit, arka peshku si dhe gjenerator nga subjekti. Lidhur me bombulat e gazit, kerkohet njoftim ISHTI per verifikim te metejshem te pajisjeve nen presion.	25.09.2025	Në përgjigje të ankesës tuaj, dërguar me email pranë Ishtit me Nr. 8926-Prot, datë 17/09/2025 ju bëjmë me dije se u ushtrua kontroll nga inspektorët e ISHTI-it në subjekt Nga verifikimi kryer rezultoi se, subjekti zotëronte rezervuar GLN me kapacitet 295 litra të pajisur me dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor, por i vendosur jashtë distancave të sigurisë në lidhje me objektet pranë tij. Nga ana e inspektorëve tanë u urdhëruar bllokimi dhe heqja e menjëhershme e rezervuarit të GLN-së dhe e kasetës të papërshtatshme ku ishte vendosur. U bë riverifikimi i situatës dhe rezultoi se rezervuari i GLN-së dhe kasetat metalike e tij janë hequr.	E plotë	0

6	25.09.2025	Ankesë lidhur me nga gazrat e leshuara nga pika e një karburanti, të cilat lëshohen në të gjithë sipërfaqen e banesës së tij nëpërmjet kolektorëve të ujit. Për sa më sipër, në bashkëpunim me ju, kërkojmë kryerjen e procedurave inspektuese, konstatuese dhe marrjen e masave	29.09.20525	Në përgjigje të ankesës tuaj, dërguar me email pranë Ishtit me Nr.9279-Prot, datë 25.09.2025, sipas të cilës deklarohet po i dëmtohet shëndeti i familjareve të tij, nga gazrat e lëshuara nga një pikë Karburanti nga ku lëshohen në të gjithë sipërfaqen e banesës së tij nëpërmjet kolektorëve të ujit, ju bëjmë me dije se u inspektua nga inspektorët e ISHTI-it në U krye kontrolli i imtësishëm vizual si dhe matja me dedektor të pranisë së gazit në të gjitha pusetat e hapura dhe kolektorët nga ku pretendohet se dalin gazrat të cilat sipas tij rrezikojnë shëndetin e familjes së tij, rezultoi se nuk ka asnjë shenjë të pranisë së tanishme ose të mëparshme të hidrokarbureve mbi ujrat ose muret e pusetave si dhe dedektorit nuk tregoi prani të këtyre gazrave. Pranë pusetave në krah të depozitave të hidrokarbureve në pikën e karburantit nuk ka asnjë shenjë të derdhjes së tyre përreth pusetave më të afërta si dhe nga kontrolli i pranisë së gazit me dedektor pranë rezervuarit të GLN, nuk rezultoi të ketë rrjedhje. Gjykojmë se është teknikisht e pamundur që edhe nëse do të kishte rrjedhje nga rezervuari i të gazit, gazi nuk mund të arrijë të rrjedhë deri në pusetat dhe kolektorët e pretenduar për shkak të pozicionit të largët të tyre, duke u derdhur më parë në sheshin përpara dhe pastaj në rrugën kryesore ku ka prani të përhershme të burimeve të ndezjes së zjarrit (automjete, kalimtarë me cigare,etj.) para se të arrijë deri në këto puseta dhe kjo kërkon kohë të gjatë, pra nuk mund të kalojë pa u pikasur më parë. Ndodhur në këto kushte, bazuar në Nenin 33 të Ligjit Nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" subjekti disponon dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor si dhe plotëson kushtet thelbësore të sigurisë në zbatim të Ligjit Nr.32 datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion" si dhe Urdhrit të Ministrit Nr. 184 datë 05.07.2005 "Kushtet teknike dhe normat e projektimit për impiantet dhe instalimet që shërbejnë për transportimin,depozitimin dhe tregtimin e naftës gazit dhe nënprodukteve të tyre".	E plotë	0
7	29.09.2025	Ankesë nga banorë të pallateve lidhur me garazhet, kanë prezence të ujrave të zeza që rrjedhin nga fuga e pallatit.Kjo ankesë është drejtuar në disa institucione me shprehje për ta zgjidhur përfundimisht këtë situatë që është e pranisë here pas here. Sot ujtat e zeza kanë depertuar tek depozitat e ujit të pijshëm,situata është shumë e rrezikshme për shëndetin e dhjetra familje, dhe kërkohej ndërhyrje urgjente,sepse është rrezik për helmime dhe shpërthime epidemike. Nderhyni menjëherë për pastrimin dhe dezinfektimin e garazhëve. Te identifikoni dhe te riparoni shkakun e daljes së ujerave të zeza(blokim i kanalizimit,lidhje e gabuar ose difekt teknik) Te merren masa për te garantuar që ky problem te mos perseritet me. Te kryhen analiza laboratorike mbi cilesine e ujit te pijshem.	03.10.2025	Referuar ankesës tuaj adresuar në info@ishti.gov.al, ju bëjmë me dije se: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (në vijim ISHTI) është institucion qëndror publik, me kompetenca në fushën e: Përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, të gazit dhe nëprodukteve të tyre, sipas legjislacionit përkatës: Sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike, sipas legjislacionit përkatës: Sigurisë së punës së instalimeve nën presion, si një linjë teknologjike e përbërë nga enë, tubacione dhe aksesore sigurie, që shërbejnë për mbajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e fluideve, sipas legjislacionit për sigurinë e enëve nën presion: Kryerjen e analizave të naftës, gazit, nënprodukteve, detergjenteve dhe tekstileve sipas standardeve. Në lidhje me kërkesën Tuaj, për kryerjen e analizave laboratorike mbi cilësinë e ujit të pijshëm, ju bëjmë me dije se kjo kërkesë nuk përfshihet në detyrat ligjore të ISHTI. Ankesa është deleguar në institucionet përkatëse	Deleguar	0